



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:098549
Datë: 08.02.2024
Numri i dokumentit: 05305101

C.nr.1160/2020

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit F.P. me numër personal me vendbanim në Prizren, tani me adresë të panjohur, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Kuvendi Komuna i Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i pronës, jashtë seance, me datë 08.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KOSNIDEROHET** se padia me shenjen C.nr.1160/2020 e datës 18.08.2020, e paditësit F.P. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Kuvendi Komuna i Prizrenit, në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të kompensimit të pronës, është **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi F.P. me vendbanim në Prizren, pranë kësaj gjykate me datë 18.08.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurit Komuna e Prizrenit- Kuvendi Komuna i Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i pronës.

Paditësit, me aktvendimin e datës 11.01.2024, i është kthyer në plotësim padia e datës 18.08.2020, që në afat prej 3 ditëve na dita e marrjes së vendimit ta plotësoj-rrregulloj padinë ashtu që kërkesëpadia të jetë e rregulluar në pikëpamje të kërkesës kryesore, sa çka konkretisht po kërkon me padi, me vërejtje si pikën II të aktvendimit. Vendimi për kthimin në plotësim-precizim të padisë, paditësit i është dërguar në adresën e cekur si në padi (..... në Prizren), por që fletëdërgesa për dorëzim personal, gjykatës i është kthye me konstatimin se *“Pala gjendet jashtë vendit, deklaron të afërmit e tij, dera e mbyllur, dt.24.01.2024”*.

Pasi që paditësi gjatë zhvillimit të procedurës ka ndërruar adresën të cilën e ka theksuar në padi dhe se nuk e ka njoftuar gjykatën për një gjë të tillë, edhe pse ishte i obliguar të bëjë një gjë të tillë, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për të vepruar sipas nenit 116 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Aktvendim gjykata ia ka komunikuar paditësit në kuptim të nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së nëpërmjet afishimit në tabelën e shpalljes të gjykatës, e kjo

sipas aktvendimit të datës 26.01.2024, me të cilin është vendosur që komunikim me paditësin të bëhet përmes tabelës së shpalljeve të kësaj Gjykate.

Gjykata konstaton se komunikimi i Aktvendimit C.nr.1160/2024 i datës 11.01.2024 paditësit Fatmir Pireci, i është bërë me datë 02.02.2024, por nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e lartpërmendur, prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ashtu që padinë e paditësit për kompensimin e pronës, e konsideroj të tërhequr.

Për arsyet e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit nenin 102.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:098549, 08.02.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.